



Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Raporti Vjetor 2020

PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT
DREJTUES TË INSTITUTIT TË
EKSPERTËVE KONTABËL TË
AUTORIZUAR PËR VITIN 2020



IEKA - Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Rr. "Elbasanit", Pallati Edil- AL IT, Tiranë, Shqipëri

Email: info@ieka.al

Web: www.ieka.al

Tel: +355 4 2346077

Mob: 0682063069

Tabela e përmbajtjes

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues _____	1
Misioni, Objektivat, Funkcionet kryesore _____	3
Raport Mbi Realizimin E Veprimtarive Të Ieka _____	7
Të dhëna mbi Audituesit Ligjorë, Shoqëritë e Auditimit dhe Kandidatët _____	16
Kualifikimi Vijueshëm i Anëtarëve dhe Edukimi i Kandidatëve _____	22
Sigurimi dhe Kontrolli i Cilësisë _____	27
Investigimi dhe Disiplina _____	29
Publikime _____	30
Veprimtari me Organizmat Kombëtare _____	32
Veprimtaritë me Organizmat Ndërkombëtare _____	34
Struktura Ekzekutive _____	38
Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare _____	40

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues

Të dashur kolegë,

Së pari uroj që të gjithë ju dhe familjarët tuaj të jeni mirë me shëndet!

Viti 2020 ka qenë një vit tejet i veshtirë për shkak të krizës shëndetësore të shkaktuar nga pandemia globale COVID-19. Kjo pandemi ndikoi jetët tona duke na kushtëzuar mënyrën e të jetuarit përfshirë këtu dhe ndikimet në financat individuale dhe publike. Qeveritë dhe autoritetet ndermorrën një sërë masash për të adresuar rreziqet shëndetësore dhe financiare që buronin nga kjo krizë. Ashtu si në të gjithë botën, edhe në Shqipëri autoritetet përgjegjëse reagues menjëherë duke ndërvepruar dhe koordinuar përpjekjet me synim minimizimin, përmes politikave mbështetëse, të efekteve negative ekonomike dhe kthimin sa më shpejt në normalitet.

Edhe Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, në këtë kuadër, ndërmori një sërë masash për t'ju ardhur në ndihmë anëtarëve të tij, duke vendosur një eksperiencë të re, atë të komunikimit të vazhdueshëm me njëri – tjetrin, të shkëmbimit të informacioneve, të ideve, të gjetjes së rrugëve të reja për të ardhur më pranë anëtarëve. Kjo bëri që të sfidohej distanca e diktuar nga Covid-19.

Falë eksperiencës 23 vjeçare të IEKAs arritëm që të jemi fleksibël dhe të përshtasim aktivitetet e IEKAs drejt digitalizimit të sistemeve të brendshme. Anëtarët e IEKAs dhe kandidatët për auditues ligjor gjatë gjithë kësaj periudhe kanë marrë pjesë në webinar për kualifikimin e vijueshëm profesional, u janë dërguar artikuj dhe si dhe informacione apo udhëzime specifike për sektorë të ndryshëm të industrisë.

Gjatë kësaj periudhe kemi qenë në vazhdimësi në ndjekje të zhvillimeve më të fundit të IFAC dhe të organizmave të tjera ndërkombëtare si EFAA, FCM për vazhdimësinë e profesionit në këto kohë të pasigurta.

Gjithashtu në këtë periudhë përmes portalit COVID-19 ju kemi mbajtur të informuar me zhvillimet e fundit rreth masave të marra ndaj pandemisë COVID-19 përmes artikujve dhe opinioneve të publikuara nga federatat dhe organizatat ndërkombëtare.

Ne do të vazhdojmë punën tonë për të ofruar eksperiencat më të mira që profesioni ynë të ndihmojë bizneset duke dhënë në këtë mënyrë ndihmesën e tij për rimëkëmbjen e vendit.

Ky është detyrimi ynë profesional dhe besoj se ne audituesit ligjorë dhe organizata jonë profesionale jemi duke e përmbushur më së miri këtë detyrim me profesionalizëm dhe kompetencë.

Këshilli Drejtues ka vijuar punën e tij për realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas programit të miratuar. KD edhe gjatë 2020 adresoi çështjet më të rëndësishme profesionale, duke ndikuar në përmirësimin e komunikimit të informacioneve për anëtarët duke i pajisur ata me shumë udhëzime dhe materiale të vlefshme dhe në dobi të rritjes së cilësisë së punës. Në zhvillimin profesional të vijueshëm, vëmendja ju kushtua nevojave që anëtarët kanë për më shumë njohuri në lidhje me zbatimin e standardeve teknike të fushës kontabël dhe të auditimit, të etikës profesionale, etj. Standardet ndërkombëtare të auditimit, të kontabilitetit e raportimit financiar përfshirë përmirësimet në kodin e etikës dhe çështjet e aktualizimit të njohurive në fushën e tatimeve dhe taksave, u trajtuan gjerësisht gjatë dy sesioneve të kualifikimit të vijueshëm.

Sfidat e ndryshme që kanë shoqëruar profesionin e audituesit ligjor nga njëra anë dhe rritja e kërkesave rregullatore nga ana tjetër nuk kanë qenë të lehta për tu menaxhuar. Megjithatë organizata jonë profesionale është përpjekur t'i përballojë sfidat duke evidentuar me kujdes problematikat në shumë aspekte të zhvillimit të profesionit e në mënyrë të veçantë në fushën e edukimit dhe cilësisë.

Edhe gjatë vitit 2020, IEKA nëpërmjet pjesëmarrjes së përfaqësuesve të saj ka dhënë

kontribut në tryeza diskutimi mbi zhvillimin e profesionit, raportimin financiar, legjislacionin fiskal, etj.

Kontributi dhe vlerësimi i organizatës tonë profesionale gjatë vitit 2020 është evidentuar edhe me pjesëmarrjen në Grupin Këshillimor Konsultativ (CAG) të Bordeve të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe atë të Etikës pranë IFAC (respektivisht IAASB dhe IESBA).

Me këtë rast dëshiroj të falenderoj anëtarët e Këshillit Drejtues, të komiteteve dhe të komisioneve, për kontributin në profesionin e audituesit ligjor, për punën e palodhshme dhe kontributin e tyre, si dhe për vlerësimin që organizata jonë profesionale ka marrë nga organizmat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Falenderoj gjithashtu edhe Drejtoreshën Ekzekutive të IEKAs dhe stafin ekzekutiv për punën dhe përkushtimin në menaxhimin e suksesshëm të aktiviteteve profesionale të organizatës tonë gjatë vitit 2020, sidomos gjatë këtij viti që ka qenë sfidues për ne të gjithë.

Ju falenderoj ju të nderuar kolegë auditues ligjorë për kontributin, arritjet, vlerësimin dhe besimin në profesionin e audituesit ligjor dhe tek organizata jonë profesionale.

Ju uroj shëndet Ju, familjarëve dhe bashkëpunëtorëve tuaj!

Me vlerësim e konsideratë,

Berti Pashko

Kryetar i Këshillit Drejtues të IEKAs

Misioni, Objektivat, FunkSIONET kryesore

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) u krijua më datën 24 Nëntor 1997, me statusin e një organizate profesionale jo fitimprurëse, që grupon profesionistët kontabël të pajisur me titullin "Auditues Ligjor" (titull i ndryshuar në vitin 2016), të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në praktikë:

- në mënyrë individuale, si person fizik
- si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese
- si i punësuar tek një tjetër auditues ligjor i regjistruar

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar ka për objekt të veprimtarisë së tij të sigurojë

ushttrimin e profesionit të audituesve ligjorë në përputhje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të tij.

Misioni i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) është të rregullojë organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara të shoqërive tregtare në zbatim të ligjit Nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar" të ndryshuar me ligjin 47/2016.

OBJEKTIVA STRATEGJIKË

Objektivat strategjike nga të cilat udhëhiqet IEKA, në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, janë:



Të sigurojë ushttrimin e profesionit të Audituesit ligjor në përputhje me ligjin



Të mbështesë respektimin e pavarësisë së anëtarëve të IEKA-s



Të garantojë mbikëqyrjen e formimit profesional të Audituesve Ligjorë



Të rritë njohjen dhe zbatimin në praktikë të standardeve me cilësi të lartë në të njëjtën linjë me zhvillimet ndërkombëtare



Të përmirësojë në vijimësi shërbimet në interes të publikut.



Të kontribuojë dhe promovojë në zhvillimin, adaptimin dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare me cilësi të lartë

Për të siguruar një vazhdimësi të profesionit të Audituesit Ligjor, Instituti synon të mbështetet në modele dhe eksperiencë të përparuara duke kombinuar përmirësimin e legjislacionit me edukimin e anëtarëve nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve profesionale cilësore nga trajnerë me përvojën më të mirë vendase dhe të huaj.

Sipas Ligjit të Auditimit, **Këshilli Drejtues i IEKAs** kryen drejtimin e veprimtarisë së Institutit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me statutin, si dhe me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve.

Këshilli Drejtues, ka përbërjen e mëposhtme:

1.	Berti PASHKO	Kryetar
2.	Arqile MISHTAKU	Zv/Kryetar
3.	Bujar OSMANI	Anëtar
4.	Shkëlzen MARGJEKA	Anëtar
5.	Rezarta KOÇOLLARI	Anëtar
6.	Elton TIRANA	Anëtar
7.	Arian CYRBJA	Anëtar

Këshilli Drejtues i IEKAs përbëhet nga 7 anëtarë. Katër anëtarë janë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme me mandat nga 1 tetor 2019 – 1 tetor 2023 (Eleonora Olli, Berti Pashko, Rezarta Kocollari, Elton Tirana) dhe tre anëtarët e tjerë janë zgjedhur me short me mandat nga 1 tetor 2019 – 1 tetor 2021 (Arqile Mishtaku, Bujar Osmani, Shkelzen Margjeka).

Këshilli Drejtues në mbledhjen e datës 1 tetor 2019 ka zgjedhur Kryetar zj. Eleonora Olli dhe zv/Kryetar z. Arqile Mishtaku. Në 9 tetor 2020 Këshilli u riformatua duke zgjedhur Kryetar z. Berti Pashko dhe anëtar z. Arian Cyrbja.

Drejtori Ekzekutiv është riemëruar nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 43 datë 20.09.2017.

Gjatë vitit 2020 Këshilli Drejtues ka realizuar 10 mbledhje dhe ka marrë gjithsej 64 vendime.

Këshilli Drejtues ka kompetencë miratimit e vendimeve, hartimit e akteve nënligjore, të cilat i dërgohen për miratim Asamblesë së Përgjithshme ose sipas rastit edhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike, hartimit e kurrikulave të përgatitjes dhe trajnimeve profesionale për

kandidatët, organizimin e kontrollit të cilësisë, etj. Në muajin janar 2020 Këshilli Drejtues ka miratuar Programin e Punës për vitin 2020.

Këshilli Drejtues harton buxhetin e organizatës profesionale IEKA, vendos për politikat e administrimit dhe për procedurat e përdorimit të mjeteve financiare dhe realizimin e veprimtarisë së tij. Në nëntor 2020, Këshilli Drejtues miratoi buxhetin vjetor 2021, i cili u miratua në Asamblesën e Përgjithshme të

Anëtarëve në muajin dhjetor të 2020. Buxheti vjetor u hartua në përputhje me parashikimet e zhvillimeve të ardhshme sipas sektorëve për vitin 2021 dhe mbështetur në të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në vitin 2019.

Objektivat kryesore që udhëhoqën hartimin e buxhetit vjetor 2021, synuan funksionimin normal të veprimtarisë së IEKAs, ruajtjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmirësimin e shërbimeve të detyrueshme për anëtarët/kandidatët, etj.

Këshilli Drejtues është informuar nga kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm për sigurimin e respektimit të ligjit dhe të akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të institucionit.

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm është përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar, auditimin e Pasqyrave Financiare vjetore, si edhe përputhshmërinë e veprimtarisë së IEKAs me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komiteti i Kontrollit të Brendshëm përbëhet nga dy anëtarë të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve më datë 30 shtator 2019:

1. Elida Miti
2. Sokol Toska

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm kontrollon veprimtarinë financiare të Institutit, mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël, pajtueshmërinë e veprimeve të regjistruara në

llogari me buxhetin, si dhe rregullsinë dhe korrektësinë e llogarive vjetore të aprovuara nga Këshilli Drejtues.

Në statut është parashikuar që pasqyrat financiare të Institutit do të auditohen nga një auditues ligjor, i cili propozohet nga Komiteti i i Kontrollit të Brendshëm.

Këshilli Drejtues është informuar nga Drejtori Ekzekutiv për realizimin e veprimtarive dhe realizimin e buxhetit në afatet kohore të parashikuara në statut.

Këshilli ka përmbushur rregullisht detyrimet e llogaridhënies ndaj anëtarësisë duke hartuar këtë raport vjetor, pjesë përbërëse të të cilit janë edhe pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare janë audituar nga audituesit ligjor:

- Rajmonda Reveli
- Shoqëria e auditimit TPA Albania, audituese ligjore Laura Gjinali.

Sipas opinionit të audituesve ligjorë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të IEKAs më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë në përputhje me politikat e përshtatura nga Këshilli Drejtues, të cilat janë bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe veçanërisht në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për OJF.

IEKA është anëtare me të drejta të plota në organizatat ndërkombëtare në vijim:

IEKA anëtare në organizatat Ndërkombëtare

IFAC - Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve



FIDEF - Federata e Ekspertëve Kontabël Frankofonë,



FCM - Federata e Ekspertëve Kontabël të Mesdheut



EFAA - Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Audituesve të Entiteteve të Vogla dhe të Mesme



CFRR - Qendra për Reformën e Raportimit Financiar në të cilën IEKA është pjesëmarrëse aktive në programet e edukimit kontabël dhe të auditimit



RAPORT MBI REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE TË IEKA

Të nderuar anëtarë,

Viti 2020 ishte një vit i vështirë për shkak të krizës së shkaktuar nga pandemia globale COVID – 19. Dua të theksoj që në fillim se Këshilli Drejtues i IEKAs ka bërë përpjekjet maksimale për përmbushjen e detyrimeve ligjore, megjithë sfidat me të cilat u ndesh gjatë vitit 2020, të cilat vazhdojnë edhe gjatë vitit 2021.

Ky Raport, si çdo vit përmbush detyrimin tonë ligjor për të raportuar përpara anëtarësisë, por edhe detyrimin për transparencë dhe llogaridhënie. Raporti Vjetor i veprimtarisë së Këshillit Drejtues përshkruan aktivitetet e IEKAs për vitin 2020, i cili synon të prezantojë, në tërësi dhe me vërtetësi punën e bërë dhe rezultatet e arritura gjatë një viti.

Si institucioni që rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtarinë e profesionit të audituesit ligjor, IEKA është përgjegjëse për programin e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve, hartimin e kurrikulave dhe programin e përgatitjes profesionale të kandidatëve, organizimin e sistemit të kontrollit të cilësisë së punës së anëtarëve, investigimin në rastet e shkeljeve të standardeve teknike dhe të etikës profesionale, si edhe sigurimin se anëtarët e saj zbatojnë praktikatat më të mira në fushën e standardeve profesionale dhe të etikës.

Periudha nga 11 Mars -23 Qershor 2020 e shpalluar si gjendje e fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë Covid 19, ka qenë një sfidë e vështirë për të gjithë ne. Këshilli Drejtues mori menjëherë disa masa për të garantuar vazhdimësinë e aktivitetit të Institutit IEKA si dhe funksionimin e profesionit të audituesit ligjor, zbutjen e efekteve negative në ndikimin në profesionin e audituesit ligjor, si dhe krijimin e premisave për një rimëkëmbje sa më të shpejtë të bizneseve në periudhën vijuese.

Edhe IEKA, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me IFAC dhe organizatat simotra, u angazhua në përpjekjet për përballimin e situatës duke koordinuar veprimet dhe duke siguruar shkëmbimin e informacionit me të gjithë anëtarët.

Puna e stafit ekzekutiv, është kryer në distancë (nga shtëpia), duke kujdesur që të mos ndërpritet asnjë nga veprimtaritë e përditshme dhe të gjithë detyrave të parashikuara në programin e punës të miratuar nga Këshilli Drejtues për vitin 2020. Gjatë kësaj periudhe u shtua informimi për anëtarët, në funksion të

nevojave të tyre për të marrë informacione në lidhje me ndryshimet më të fundit në legjislacion, masat e vazhdueshme të marra nga autoritetet, udhëzimet e qeverisë, etj. Një pjesë e rëndësishme e këtij komunikimi i është kushtuar udhëzimeve praktike dhe ideve të ndryshme për mënyrën se si duhet të veprojnë audituesit në këto kohë të pazakonta veçanërisht me klientët e auditimit.

Me propozimin e IFAC-ut u bë e mundur hapja e rubrikës Covid-19, në të cilën u publikuan dhe përditësuan në mënyrë të vazhdueshme si masat e marra nga qeveria shqiptare për kujdesin dhe përballimin e pandemisë, por edhe një numër i konsiderueshëm artikujsh të përkthyer nga publikimet e organizatave profesionale në të cilat IEKA është anëtare si IFAC, EFAA, FCM, FIDEF, etj. Në këto artikuj jepen këshilla për audituesit ligjorë për mënyrën se si duhet të sigurojnë të dhënat e duhura për të kryer auditimin në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit edhe në kushtet kur ka vonesa, pamundësi dhe vështirësi në aksesimin e të dhënave të klientëve.

Auditimi i pasqyrave financiare 2019 gjatë pjesës së parë të vitit 2020 kanë qenë një sfidë e madhe për audituesit ligjorë pasi edhe në kushtet e jashtëzakonshme të krijuar nga pandemia COVID 19, kanë vijuar përpjekjet për të siguruar një cilësi të lartë të auditimit, duke zbatuar kërkesat e SNA-ve, veçanërisht ato që lidhen me vlerësimin e rrezikut të auditimit, sigurimin e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit si dhe kërcënimin e shkaktuar nga rreziqe të reja si ato të vijimësisë së entitetit, etj.

Sfida kryesore që prej shpërthimit të pandemisë COVID-19 ishte përshtatja me realitetin e ri dhe adresimi i efekteve në auditimin ligjor dhe shërbimet e tjera, situatë në të cilën Këshilli Drejtues mori disa masa për të garantuar vazhdimësinë e aktivitetit të Institutit IEKA si dhe funksionimin e profesionit të audituesit ligjor.

Mesazhi ynë kryesor është se profesioni i audituesit ligjor i ka premisat ta përballojë këtë sfidë të vështirë, duke kontribuar në rimëkëmbjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Në këtë raport, do të evidentohen si arritjet ashtu edhe problemet dhe sfidat me të cilat është përballuar KD gjatë kryerjes së rolit të tij të drejtimit dhe qeverisjes midis dy mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve. Siç tashmë ju e dini, 2021 do të jetë një vit zgjedhor për Këshillin Drejtues. Në asamblenë e Përgjithshme të Anëtarëve të muajit shtator 2021, do të zgjidhen tre anëtarë të Këshillit Drejtues që do të kenë mandatin e tyre për një periudhë 4-vjeçare duke siguruar në këtë mënyrë vijimësinë në organet drejtuese.

Këshilli Drejtues gjatë vitit 2020, në funksion të forcimit të integritetit të Institutit IEKA, por edhe të rritjes së kapaciteteve të tij ndërmori një sërë hapash të rëndësishëm për profesionin e Audituesit Ligjor, ndër të cilat mund të përmendim:

- Ka miratuar Draftin e ndryshimeve të VKM nr.17 datë 16.01.2019, “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”, të cilin pas dakordësimit me përfaqësuesit e 6 shoqërive të mëdha audituese, i është dërguar zyrtarisht Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Ky Draft ka mbajtur parasysh se rritja e konsiderueshme e numrit të shoqërive me interes publik do të kishte pasoja dhe ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kostos së biznesit, si dhe në tejkalim të kërkesave ligjore dhe frymës së dokumentave bazë që rregullojnë veprimtarinë e audituesve ligjorë në vendin tonë:

- (i) Ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar - neni 2, pika 23, gërma ç;
 - (ii) Direktivës së Auditimit ligjor (2006/43/EC of the European Parliament and of the Council) - neni 2, pika 13, gërma d; si edhe
 - (iii) Kodit të Etikës për profesionistët kontabël të IAESB të IFAC [International Independence Standards (Parts 4a and 4b)] - paragrafi 400.8
- Pas ezaurimit të përpjekjeve për të ndryshuar aktet nënligjore të hartuara dhe miratuara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (rregullorët), për të cilat është evidentuar mospërputhshmëri ligjore, ka vendur të ngrejë padi për shfuqizim të pjesshëm në Gjykatën Administrative të Apelit.
 - Vazhdimin e përpjekjeve për marrjen e delegimit nga BMP të kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike, të cilat nuk janë me interes publik në përputhje me nenin 39 të ligjit të auditimit, duke argumentuar se IEKA ka patur dhe vijon të ketë në funksionim një sistem efikas të kontrollit të cilësisë dhe do të angazhojë individë që përmbushin kriteret ligjore të kërkuara, për të garantuar realizimin me sukses të tij. Këto përpjekje u formalizuan në shkurt 2021 me nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi mes IEKAs dhe BMP dhe mbetemi në pritje të plotësimit të pikave të marrëveshjes.
 - Gjatë 2020 veprimtaritë e KD u adresuan fillimisht në orientimin e përdorimit të platformave të komunikimit online Google Classroom, Webinar, ZOOM, si një mundësi për të bërë të mundur organizimin normal të mbledhjeve të Këshillit Drejtues dhe komiteteve por edhe për tu përdorur në kualifikimin e anëtarëve të IEKAs dhe të kandidatëve për auditues ligjorë. Rritja dhe diversiteti i anëtarësisë kërkojnë që edhe në të ardhmen të përdoren zgjidhje të tilla inteligjente dhe shumëqëllimshë.
 - Këshilli Drejtues ka miratuar dhe dërguar në organizatat ndërkombëtare në të cilat IEKA është e anëtarësuar të gjitha materialet lidhur me detyrimet e anëtarësisë si Action Plan SMO dhe DASH Board, raporte të ndryshme të veprimtarisë, pyetsorë, raporte statistikore etj. Drejtuesit e lartë

të IFAC-ut kanë vlerësuar punën e bërë nga IEKA në drejtim të Planit të Veprimit SMO, i cili është publikuar në faqen e internetit të IFAC, duke e konsideruar atë si një arritje të rëndësishme për organizatën tonë profesionale. Plani i veprimit i përditësuar, sipas njoftimit të Departamentit të Cilësisë dhe Zhvillimit të IFAC, do të dorëzohet në 2023.

- Një ndër çështjet më të rëndësishme që ju kushtua prioritet gjatë vitit 2020 ishte komunikimi i informacioneve për anëtarët duke i pajisur ata me shumë udhëzime, guida dhe materiale të vlefshme për impaktin e Covid 19 në auditim. Në zhvillimin profesional të vijueshëm, vëmendja ju kushtua nevojave të anëtarëve në lidhje me zbatimin e standardeve teknike të fushës kontabël dhe të auditimit, të etikës profesionale, etj. Standardet ndërkombëtare të auditimit, të kontabilitetit e raportimit financiar përfshirë përmirësimet në kodin e etikës, praktika auditimi mbi Covid-19, raste të gjetjeve të kontrollit të cilësisë që nga pranimi i angazhimit /vazhdimi /raportimi, çështjet e aktualizimit të njohurive në fushën e tatimeve dhe taksave, legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave, Manuali i Doganës me raste praktike etj. u trajtuan gjerësisht gjatë dy sesioneve të kualifikimit të vijueshëm në muajin tetor dhe nëntor 2020.
- Për disa nga modulet profesionale sipas Kurrikulës së miratuar të Profesioneve të Audituesve Ligjorë u bënë përmirësime bazuar në një analizë të detajuar të metodës së integruar të edukimit. Është përkthyer teksti KAPLAN i ACCA për Modulin e Raportimit Financiar të Avancuar (pjesa II) i cili është zhvilluar me kandidatët e vitit të parë. (më parë kanë qenë përkthyer tekstet respektive të auditimit e dhënies së sigurisë në nivel të avancuar dhe menaxhimit të performancës në nivel të avancuar).

Veprimtaritë trajnuese të anëtarëve u plotësuan me botime të reja profesionale të IFAC-ut për të mbuluar zhvillimet e reja, përmirësimet në standardet e auditimit, standardet për shërbimet e rishikimit, të sigurive të tjera, të kontrollit të cilësisë, shërbimet e lidhura, etj.

Për shkak të situatës globale të krijuar nga COVID-19, **zhvillimi i Asamblesë u realizua online në datën 17 Dhjetor 2020.** Asambleja u hap në orën 10.30 për të gjithë anëtarët e IEKAs në platformën ZOOM Webinar ndërsa votimi u krye në platformën "Simply Voting" e cila është një format online ku votuan të gjithë anëtarët. Kjo platformë me referenca pozitive të shumë organizatave dhe institucioneve prestigjioze në mbarë botën, të cilat i ka asistuar të kryejnë me sukses zgjedhje on-line, duke i siguruar efikasitetin, saktësinë e procesit dhe anonimat e votës. Përdorimi i kësaj platforme dhe verifikimi i çdo procedure nga Komisioni i Votimit, ishte një garanci për transparencën e zgjedhjeve.

Zhvillimi i Asamblesë nëpërmjet platformës së votimit është në përputhje me Statutin e IEKAs i cili në nenin 12.3 parashikon mundësinë e votimit edhe në mënyrë elektronike. Nëpërmjet kësaj platforme ruhet anonimati i votës. Sipas nenit 12.3 të Statutit të IEKAs, “Votimi është i fshehtë, me përjashtim të rasteve kur në këtë statut është parashikuar ndryshe dhe mund të realizohet edhe në mënyrë elektronike”.


Në përfundim të votimit, rezultati i votimit ishte i aksesueshëm nga të gjithë anëtarët e IEKAs. Komisioni i Votimit shpalli rezultatin e votimit për vendimet të cilat u miratuan me shumicë votash:

- Raporti për Veprimtarinë e Këshillit Drejtues gjatë vitit 2019 dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2019.
- Raporti i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm për veprimtarinë financiare të IEKA-s për vitin 2019.
- Buxheti i parashikuar i IEKA-s për vitin 2021.
- Miratimi i kuotës fikse në Shumën 60.000 lekë duke filluar nga viti 2021 e në vijim.

Gjatë vitit 2020, vijoi puna për përkthimin në gjuhën shqipe të Handbook Volumi III 2018 të IAASB dhe të Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël, botim i vitit 2018, të cilat janë publikuar në faqen e web-it të IEKAs dhe u janë dërguar me email të gjithë anëtarëve dhe kandidatëve (këto standarde dhe kodi IESBA janë në fuqi aktualisht).

Këto standarde janë publikuar në faqen e web-it të IEKAs, në rubrikën Standardet Profesionale, sipas Manualit të Deklaratave Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurimeve të Tjera dhe Shërbimeve të Lidhura.

Manuali i Deklaratave Ndërkombëtare, botimi i vitit 2018, përmbledh paketën e plotë të Deklaratave të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit e Sigurisë, të Standardeve mbi Kontrollin e Cilësisë, Auditimin, Rishikimin, Sigurive të tjera dhe Shërbimeve të Lidhura, si dhe Direktivën jo Detyruese të Praktikave Ndërkombëtare të Auditimit. Manuali, së bashku me ndryshimet nga amendimet konformuese përkatëse ka të përfshirë në të edhe standardet e rishikuara si më poshtë:

		
SNA 250 (i rishikuar) - Mbajtja Parasysh e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare SNA 260 (i rishikuar) - Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen SNA 315 (i rishikuar) - Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij SNA 540 (i rishikuar) - Auditimi i Çmuarjeve Kontabël dhe Informacionet Përkatese Shpjeguese SNA 570 (i rishikuar) - Vijmësia SNA 610 (i rishikuar) - Përdorimi i Punës së Audituesve të Brendshëm SNA 800 (i rishikuar) - Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Pasqyrave Financiare të Përgatitura në Përputhje me Kuadrot për Qëllime të Veçanta SNA 805 (i rishikuar) - Konsiderata të Veçanta – Auditimet e Elementëve, Llogarive ose Zërave të Veçantë të një Pasqyre Financiare SNA 810 (i rishikuar) - Angazhimet për Raportimin mbi Pasqyrat Financiare të Përmbledhura	Gjatë vitit 2020 Instituti përfundoi punën duke përkthyer dhe rishikuar në gjuhën Shqipe, Volumnin e tretë të IAASB-së, Manuali i Deklaratave Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurive të Tjera dhe Shërbimeve të Lidhura (publikuar në faqen e web-it të IEKAs). <u>Volumi III i këtij Manuali përfshin:</u> 1. Kuadrin e IAASB për Cilësinë e Auditimit: Elementët kryesore që krijojnë një mjedis për cilësinë e auditimit; dhe 2. Kuadrin Ndërkombëtar për Angazhimet e Sigurisë. Kuadri i IAASB për Cilësinë e Auditimit, <i>Elementët kryesore që krijojnë një mjedis për cilësinë e auditimit</i>, është një nga temat e rëndësishme, me fokus kyç për IAASB. Kuadri Ndërkombëtar për Angazhimet e Sigurisë, përcakton parimet të një niveli të lartë të zbatueshme për të gjitha angazhimet e sigurisë	Gjithashtu gjatë vitit 2020 nga IEKA është përkthyer volumi i ri dhe i ristrukturuar i Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël (Përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) i publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët, ose siç njihet gjerësisht, Kodi IESBA. Kryetari i BSNEK-së, Dr. Stavros Thomadakis ka theksuar se “Ky është një moment revolucionar në shërbim të interesit publik. Kodi tani është një platformë e forcuar ndjeshëm, ai është ri- dizajnuar për përdorim më të gjerë, duke ruajtur zbatueshmërinë globale. Kodi thekson rëndësinë e parimeve themelore për të gjithë profesionistët kontabël. Tashmë fillon puna kritike brenda firmave, organeve të hartimit të standardeve, rregullatorëve dhe organeve të mbikëqyrjes së auditimit, organizatave të edukimit, organizatave anëtare të FNK-së dhe të tjerëve, në vetëdijësimin mbi Kodin dhe në mbështetje të adoptimit dhe zbatimit të tij”.

Një vëmendje e veçantë, ndër të tjera i është kushtuar Standardit Ndërkombëtar të Auditimit - SNA 540 (i rishikuar) "Auditimi i Çmuarjeve Kontabël dhe Informacionet Përkatëse Shpjeguese", i cili hyn në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë më datë 15 Dhjetor 2019 dhe pas kësaj date. Në mbështetje të anëtarëve për t'i ndihmuar në përdorimin dhe zbatimin e këtij standardi, IEKA ka publikuar në faqen e web materiale të ndryshme udhëzuese dhe informuese të marra nga IFAC. SNA 540 (i rishikuar) ka në objektivin e vetë përgjegjësitë e audituesit në lidhje me çmuarjet kontabël dhe informacionet përkatëse shpjeguese në auditimin e pasqyrave financiare.

Të dy volumet e Manualit të Deklaratave Ndërkombëtare (Volumi I dhe III) u publikuan gjatë vitit 2020 në faqen e web-it të IEKAs, si dhe u shpërndanë për të gjithë anëtarët në adresat e postës elektronike e-mail. Gjatë vitit 2020 është duke vazhduar puna për përkthimin e Volumit të II të Manualit të Deklaratave Ndërkombëtare të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS/IAASB).

Një nga objektivat kryesore të punës së IEKAs mbetet kontrolli i zbatimit të kërkesave të SNA-ve. Për këtë qëllim duhet të përdoren më mirë se deri më sot, instrumentet e kontrollit të cilësisë, pasi ato të na autorizohen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike dhe të hartohen e zbatohen rregulla të veçanta për kontrollin e zbatimit të parimeve etike e kërkesat e pavarësisë, duke i lidhur papajtueshmëritë kur ato janë të rëndësishme edhe me procedurat e investigimit dhe të disiplinës së brendshme të IEKAs.

Duke qenë se në vitin 2020, angazhimet e tjera zënë rreth 46.7% të totalit të angazhimeve të kryera nga audituesit ligjorë, kontrolli i cilësisë së punës së shërbimeve të tjera mbetet një nga objektivat që IEKA duhet të arrijë në periudhën në vijim.

IEKA do të vijojë të bëjë përpjekje që roli i saj të mbetet ai i njërit prej autoriteteve rregullatore kompetente të profesionit, me qëllim që të ketë rol e përgjegjësi në çështje të tilla si kontrolli i cilësisë, investigimi, edukimi i kandidatëve dhe anëtarëve, përgatitja e udhëzuesve dhe procedurave të punës profesionale, etj. Raportet midis IEKAs dhe BMP janë e do të jenë në evoluim të vazhdueshëm dhe do të kushtëzohen gjithmonë me zhvillimet që mund të ndodhin në mjedisin European dhe me hapat integruese që do të bëjë vendi ynë në vitet e ardhshme.

Nisur nga praktikat e shumë vendeve të BE-së dhe atyre aspirante, roli i Bordit të Mbikëqyrjes Publike në një të ardhme të afërt duhet fokusohet direkt dhe vetëm në kontrollin e cilësisë, të audituesve dhe auditimeve të entiteteve me interes publik, siç janë Bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimit dhe të ri-sigurimit, si dhe një numër ndërmarrjesh të mëdha, me pronësi shtetërore dhe/ose private, që janë përcaktuar nga qeveria si entitete me interes publik.

Në vitin 2020 IEKA ka përmirësuar procesin e edukimit dhe përkthimin e teksteve të ACCA (Kaplan Publishing) që janë përdorur si module të përgatitjes së profesionistëve në vendin tonë. Instituti filloi procesin e edukimit profesional të

kandidatëve sipas kurrikulës së re të miratuar për profesionin e audituesit ligjor. Për herë të parë nisi në vitin 2019 trajnimi i kandidatëve të vitit të parë me modulën profesionale (niveli i avancuar) në lëndën **“Raportimi Financiar i Avancuar”**. Vazhdimi i trajnimit me këtë modul u realizua në vitin 2020. Gjatë 3 viteve të praktikës profesionale, kandidatët për auditues ligjorë do të trajnohen me modulet si vijon:

- Raportimi Financiar i Avancuar
- Tatime dhe taksa – Nivel i Avancuar
- Legjislacioni i Biznesit – Nivel i Avancuar
- Drejtimi i Performancës – Nivel i Avancuar
- Auditim & Dhënie Sigurie – Nivel i Avancuar
- Etika Profesionale

Ndryshimet që kanë pasuar miratimin e kurrikulës së plotë të audituesit ligjor dhe veçanërisht iniciimi i shkollës postmaster të IEKAs, tregon se ky proces është në rrugën e një përmirësimi të vazhdueshëm.

Versionet më të fundit të materialeve të ACCA-së u janë vënë në dispozicion kandidatëve për Auditues Ligjor që ndjekin praktikën profesionale. Aktualisht është përkthyer nga libri i ACCA “Raportimi financiar” (niveli i avancuar), moduli i parë dhe i dytë për trajnimet e kandidatëve për Auditues Ligjor, që përfshin tema të tilla si: aktivet, kurset e këmbimit, qiraja financiare, ngjarjet pas datës së bilancit, instrumentat financiare, kontabiliteti i grupit etj. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që kandidatët për Auditues Ligjor në Shqipëri të përgatiten në të njëjtën mënyrë si të gjithë

kandidatët e tjerë në të gjithë botën. Megjithatë mbetet ende shumë për të bërë në drejtim të monitorimit të praktikës profesionale dhe garantimit të një udhëheqje profesionale dhe cilësore.

Lidhur me kualifikimin e vijueshëm të anëtarëve, Instituti ka treguar shumë kujdes në përzgjedhjen e temave të duhura dhe angazhimin e lektorëve të kualifikuar. Në kushtet e zbatimit të masave të rekomanduara nga Qeveria Shqiptare për ruajtjen e distancimit social, si dhe duke respektuar masat e sigurisë për kufizimin e transmetimit të COVID-19, mori një rëndësi të veçantë organizimi i trajnimeve online. Kjo formë trajnimi është e rekomanduar edhe nga IFAC dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, në të cilat IEKA është e anëtare me të drejta të plota.

Megjithë rolin e rëndësishëm të IEKAs dhe të anëtarëve të saj për përmirësimin e raportimit financiar në vendin tonë, ka nevojë për përmirësim në drejtim të cilësisë së shërbimeve profesionale, të respektimit të procedurave të parashikuara në standardet e auditimit, të raporteve të auditimit dhe të sigurive të tjera, respektimit të Kodit të Etikës, të rotacionit të audituesve pas përfundimit të periudhës kufi të përcaktuar nga ligji i auditimit, të vlerësimit të konflikteve të interesit nga dhënia e shërbimeve të tjera si kontabilitet, këshillime fiskale për të njëjtin klient auditimi, përdorimi i tarifave të ulëta në auditim, mosdeklarimi i misionëve dhe moslikuidimi në kohë i kuotave profesionale, etj.

Faqe e internetit të IEKAs vazhdon të pasurohet në mënyrë aktive me materiale të dobishme për audituesit ligjorë. Gjatë këtij viti është publikuar edhe Kodi i ri i Etikës dhe tools-et eCode, të cilat do t'ju vijnë në ndihmë anëtarëve të IEKAs gjatë përdorimit të Kodit të Etikës. Një faqe e re web-i, e cila do të jetë më interaktive dhe profesionale, është përgatitur dhe do të lancohet së shpejti. Regjistri Publik i Audituesve Ligjor, aktualisht është lehtësisht i aksesueshëm për përdoruesit aktualë dhe potencial dhe është i publikuar në faqet e institucioneve të rëndësishme kombëtare si: QKB, Gjykatat, etj.

Gjatë vitit 2020, vazhduan marrëdhëniet institucionale të IEKAs me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik e të Sipërmarrjes, Qendrën Kombëtare të Biznesit, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Drejtorinë e

Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, etj.

Zhvillime të reja dhe konsolidim njohën edhe marrëdhëniet e IEKAs në sferën ndërkombëtare, me organizata të tilla si IFAC, FCM, FIDEF, EFAA, Banka Botërore, CFREP Reparis - Vienë, ACCA, FEE, etj.

Rritja e rolit dhe përmirësimi i reputacionit të Audituesit Ligjor dhe të organizatës sonë profesionale mund të bëhet realitet vetëm nëse ne do të kombinojmë më mirë se deri më sot rolin e organeve të zgjedhura me ato ekzekutive, nëse mendojmë seriozisht për investime afatgjata në burimet njerëzore, me synim fuqizimin administratës ekzekutive, në funksion të përmirësimit të qeverisjes së Institutit dhe rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë. Vetëm në këtë mënyrë nga njëra anë interesi publik trajtohet me prioritet dhe nga ana tjetër mbrohet nderi dhe reputacioni i individit.



Të dhëna mbi Audituesit Ligjorë, Shoqëritë e Auditimit dhe Kandidatët

Nga të dhënat e Regjistrimit Publik të IEKAs, në fund të vitit 2020 rezultojnë të regjistruar 231 Auditues Ligjorë, nga të cilët 127 femra (55%) dhe 104 meshkuj (45%), si dhe 58 shoqëri audituese.



127 femra

104 meshkuj


Gjatë vitit 2020 ka rezultuar se janë çregjistruar në mënyrë definitive 5 Auditues Ligjorë për shkak se mbushën moshën e daljes në pension.

Të regjistruar në Regjistrin Publik edhe për vitin 2020 vijnë të jenë 4 auditues ligjorë me titullin CPA (të marrë në SHBA) dhe 16 auditues ligjorë të pajisur me titullin ACCA.

Për vitin 2020, përbërja e anëtarëve të organizatës profesionale vijon të jetë si më poshtë:

- 147 AL e ushtrojnë profesionin si persona fizikë, nga të cilët 83 femra dhe 64 meshkuj;
- 83 AL janë të angazhuar në shoqëri auditimi, nga të cilët 43 femra dhe 40 meshkuj; dhe
- 1 AL e ushtron profesionin si i punësuar te një tjetër Auditues Ligjor i regjistruar

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike ushtrimi i profesionit nga audituesit ligjorë deri në datë 31.12.2020:




Sipas nenit 32, pika 2 e Ligjit Nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, Audituesi Ligjor mund ta ushtrojë profesionin:

1. në mënyrë individuale;
2. si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese;
3. i punësuar te një tjetër auditues ligjor i regjistruar.



Nga 58 shoqëri auditimi rezulton se:

- 66 % ose 38 shoqëri auditimi ose janë vetëm me një Partner Angazhimi /Auditues Ligjor;
- 26% ose 15 shoqëri auditimi janë me dy partnerë;
- 8% ose 5 shoqëri auditimi janë me tre partnerë auditimi;

Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike ushtrimi i profesionit në shoqëri auditimi sipas partnerëve të angazhimit/ortakëve deri në datë 31.12.2020:



Në grafikët në vijim paraqiten shpërndarjet e grupmoshave përbërëse të anëtarësisë së Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar:



Gjatë vitit 2020 krahasuar me të dhënat e vitit 2019, vihet re:

- rritje e audituesve ligjorë në grupmoshat:
 1. < 30 vjeç;
 2. 31-40 vjeç;
 3. 41-50 vjeç
- rënie në grupmoshën >60 vjeç.
- nuk ka ndryshim me vitin 2019 për grupmoshën 51-60 vjeç.

Në Regjistrin Publik të Audituesve Ligjore të IEKAs, krahas katër firmave më të mëdha audituese:

- Deloitte
- KPMG (çregjistruar në 2020)
- PricewaterhouseCoopers
- Ernst & Young


rezultojnë të regjistruar edhe degë apo përfaqësues të firmave pjesë e rrjeteve ndërkombëtare të tilla si:

- BDO, Baker Tilly, Crowe, Ficadex, Grant Thornton, Kreston,
- Mazars, Moore Stephens, Russel Bedford, RSM, TPA, UHY.

Në objektin e veprimtarisë së këtyre shoqërive përfshihet auditimi ligjor i pasqyrave financiare të njësive ekonomike, institucioneve financiare bankare dhe jo bankare, sipas kërkesave të ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” (i ndryshuar). Kryesisht në secilën nga këto shoqëri ushtrojnë profesionin 2 deri në 3 Auditues Ligjorë, të regjistruar në Regjistrin Publik të IEKAs.

Audituesit Ligjorë (AL) janë të përqëndruar kryesisht në Tiranë, por duhet theksuar se në Regjistrin Publik të IEKAs janë të regjistruar profesionistë nga të gjitha trevat e Shqipërisë. Shpërndarja gjeografike e audituesve ligjorë, ilustrohet në tablën dhe grafikun në vijim:

Shpërndarja gjeografike e AL	Nr. i AL
• Tiranë	178
• Durrës, Elbasan	20
• Korçë, Pogradec	7
• Fier, Lushnjë, Berat	9
• Vlorë, Sarandë, Tepelenë	8
• Shkodër, Lezhë	9



Praktika profesionale e kandidatëve për Auditues Ligjorë më 31.12.2020

- 127 kandidatë po kryejnë praktikën profesionale për auditues ligjor, nga të cilët 92 kandidatë janë femra, ndërsa 35 janë meshkuj.


92 femra




35 meshkuj

- Pranimi i kandidatëve në praktikën profesionale për vitet 2016-2020 është si më poshtë:
 - në vitin 2016 u pranuan 53 kandidatë, nga të cilët 38 femra dhe 15 meshkuj
 - në vitin 2017 u pranuan 21 kandidatë, nga të cilët 13 femra dhe 8 meshkuj
 - në vitin 2018 u pranuan 19 kandidatë, nga të cilët 18 femra dhe 1 meshkuj
 - në vitin 2019 u pranuan 43 kandidatë, nga të cilët 28 femra dhe 15 meshkuj
 - në vitin 2020 u pranuan 35 kandidatë, nga të cilët 22 femra dhe 13 meshkuj

Paraqitja grafike e regjistrimit të kandidatëve në praktikën profesionale është si në vijim:



Regjistrimi i kandidatëve për hyrjen në praktikën profesionale u krye në periudhën nga data 1 deri 15 Nëntor 2020 në zbatim të Rregullores së Edukimit. Duke filluar nga viti 2017 kandidatët zhvillojnë praktikën profesionale nën udhëheqjen e Audituesit Ligjor **vetëm me marrëveshje dhe kontratë pune me kohë të plotë 3 vjeçare**. Me ndryshimet ligjore që hynë në fuqi në vitin 2016, kandidatët për auditues ligjorë e kryejnë praktikën profesionale me kontratë pune me kohë të plotë. Kandidatët që kryejnë praktikën profesionale me marrëveshje/kontratë pune 5 vjeçare janë ata të regjistruar përpara ndryshimeve të ligjit. Pranimet në praktikën profesionale gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019 kanë patur tendencë në ulje. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i kandidatëve që zhvillojnë praktikën profesionale i ndarë sipas grupmoshës:



Nga tabela më sipër vërehet se gjeneratat e reja të cilët kanë përfunduar ciklin e studimeve universitare në nivelin e dytë (Master), kanë më shumë interes për të kryer praktikën profesionale dhe të thellojnë njohuritë në fushën e profesionit të auditimit. Kandidatët që kryejnë praktikën profesionale të ndarë sipas viteve dhe llojit të marrëveshjes/kontratës së punës në fund të vitit 2020, kandidatët paraqiten si në tabelën në vijim:

Kandidatë	Kontratë 3 vjeçare	Kontratë 5 vjeçare	Gjithsej
Viti i 1	43		43
Viti i 2	36		36
Viti i 3	22	1	23
Viti i 4	2	3	5
Viti i 5	1	4	5
Totali 2020	104	8	112
Për mbrojtje punimi	8	7	15



Kualifikimi Vijueshëm i Anëtarëve dhe Edukimi i Kandidatëve

Në zbatim të programit të punës për vitin 2020, i cili është miratuar nga Këshilli Drejtues i IEKAs, si edukimi i kandidatëve edhe kualifikimi i vijueshëm është kryer nga lektorë profesionistë me eksperiencë, duke synuar rritjen e cilësisë së kualifikimit të anëtarëve dhe kandidatëve tanë. Programi i kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve është hartuar duke marrë në konsideratë edhe propozimet e ndryshme nga anëtarët e IEKAs. Këshilli Drejtues në bashkëpunim me Stafin Ekzekutiv kanë organizuar gjatë vitit 2020, dy sesione të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të IEKAs.

Gjatë vitit 2020 Komiteti i Edukimit dhe Zhvillimit të Vijueshëm Profesional ka kryer funksionin e tij me përbërjen më poshtë:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Rezarta Koçollari | Kryetar |
| 2. Doranin Agalliu | Anëtar |
| 3. Kledian Kodra | Anëtar |
| 4. Julian Naqellari | Anëtar |

Kualifikimi i Vijueshëm i Anëtarëve të IEKA-s

Referuar Ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” (të ndryshuar), *Audituesit ligjorë i nënshtrohen kualifikimit të vijueshëm profesional, i cili është i detyrueshëm dhe zgjat, të paktën, 40 orë.*

Nga situata e pandemisë botërore për shkak të COVID-19 dhe masave të marra nga Qeveria Shqiptare për ndalimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura, Këshilli Drejtues ka vendosur që trajnimet e anëtarëve të bëhen online nëpërmjet aplikacionit ZOOM Webinar. Në zbatim të vendimit të Keshillit Drejtues, stafi ekzekutiv ka testuar përdorimin e platformës së komunikimit online të aplikacionit “ZOOM Webinar” duke bërë të mundur zhvillimin me sukses të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve në dy sesione. Ky aplikacion ka qenë lehtësisht i përdorshëm dhe i aksesueshëm për anëtarët dhe ka mundur një kapacitet më të madh të pjesëmarrësve.

Sipas Programit të Kualifikimit të Vijueshëm – Viti 2020 miratuar me Vendim të KDs së IEKAs datë sipas seksioneve janë kryer këto tema:

- Sesiioni i parë 27, 28 dhe 29 tetor 2020 (16 orë)
 - Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA 540) dhe Standarde Ndërkombëtare Auditimi të tjera;
 - Gjetjet ISQC. Kujtesë për zbatimin e SNKC 1;
 - Ligji "Për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin" në Republikën e Kosovës;
 - Praktika Auditimi mbi Covid-19 Raportimi Financiar dhe Auditimi;
 - Struktura, raporti dhe përmbajtja sipas Ligjit të Kontabilitetit;
 - Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF 9).
- Sesiioni i dytë 17, 18, 19 dhe 20 tetor 2020 (24 orë)
 - Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF 13- Matja me vlerën e drejtë);
 - Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF 16- Qiratë);
 - Fiskalizimi;
 - Standardet e Auditimit dhe Auditimi i Pasqyrave Financiare (raste praktike për SNA 705 dhe SNA 706);
 - Kodi i Etikës IESBA, kërkesat kryesore etike të profesionistëve kontabël në praktikën publike;
 - Legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
 - Manuali i Doganës, raste praktike;
 - Case Ware / Pack PEE.

Trajnimi i Kandidatëve të IEKAs

Gjatë kryerjes së praktikës profesionale kandidatët ndjekin edukimin profesional të avancuar që realizohet me pjesëmarrjen në trajnime, leksione, seminare dhe testimet përkatëse për njohuritë e aftësitë profesionale, sipas moduleve që përmban programi.

Programi i studimeve post master për marrjen e titullit "Auditues Ligjor" realizohet nga dhe pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) me kohëzgjatje normale jo më pak se 3 vite kalendarike.

Disiplinat dhe veprimtaritë e tjera formuese, që zhvillohen në këtë program studimi gjatë 3 viteve të praktikës profesionale, përfshijnë modulet profesionale të një niveli të avancuar, si më poshtë:

1. Moduli Raportimi Financiar i Avancuar;
2. Moduli Taksimi i Avancuar;
3. Moduli Legjislacioni i Biznesit i Avancuar;
4. Moduli Auditim dhe Dhënie Sigurie i Avancuar
5. Moduli Drejtimi i Performancës i Avancuar
6. Moduli Etika Profesionale

Në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues të IEKAs Nr 37 datë 20.09.2017 për miratimin e Kurikulës së Profesionit të Audituesit Ligjor me konsulencën e projektit të BB, në muajin Korrik 2019 nisi për herë të parë kualifikimi i 43 kandidatëve të vitit të parë 2019 me modulet profesionale sipas Kurikulës së Profesionit të AL (Niveli Profesional i avancuar), të cilat kryhen vetëm nga organizata profesionale e Audituesve Ligjorë.

Trajnimet janë kryer online nëpërmjet aplikacionit ZOOM Webinar. Përpara zhvillimit të trajnimit, lektorët dhe kandidatët kanë marrë instruksionet e nevojshme nga sektori i edukimit.

Sipas kalendarit të miratuar nga Këshilli Drejtues, për kandidatët e **vitet të parë** u realizua trajnimi sipas Moduleve më poshtë:

Moduli	Moduli 1	Moduli 1	Moduli 2
Nisur në 5 Qershor 2020	Nisur në 16 Qershor 2020	Nisur në 9 Shtator 2020	Nisur në 2 Nentor 2020
20 orë	28 orë	28 orë	46 orë
Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK)	Raportimi Financiar i Avancuar (AFR -pjesa 1)	Raportimi Financiar i Avancuar (AFR -pjesa 2)	Taksimi i Avancuar

Trajnimi i kandidatëve të vitit të parë filloi në muajin qershor 2020 me modulën profesionale (niveli i avancuar) në lëndën “Raportimi Financiar i Avancuar” dhe do të vazhdojë gjatë viteve të praktikës profesionale në modulet e tjera.

Materialet e trajnimit për këtë modul së bashku me ushtrimet praktike dhe rastet studimore u përkthyen nga stafi ekzekutiv i IEKAs sipas tekstit P2 (Corporate Reporting, botimet KAPLAN) dhe u rishikuan nga lektorët e angazhuar në trajnime. Tashmë ka përfunduar përkthimi i të gjithë kapitujve të tekstit CORPORATE Reporting P2.

Nisur nga fakti se Standardet Kombëtare të Kontabilitetit kanë një zbatim më të madh në vendin tonë, me propozim të KEKV, me miratim nga Këshilli Drejtues i IEKAs, kandidatët që kryejnë praktikën profesionale të vitit të parë 2019 zhvilluan 5 ditë/20 orë kualifikim për Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Për herë të parë në vitin 2020 IEKA realizoi trajnimin e kandidatëve edhe në Modulën e Taksimit të Avancuar. Në kuadër të projektit të BB “Support IEKA with financing for translation of training

materials” me Nr Ref. No AL-EQ-FINREP/1.5-CS/IC janë përkthyer nga përkthyes të kontraktuar tekstet e Kaplan për librat APM (e plotë) dhe AAA (½ e tekstit). Gjatë vitit 2021 do të zhvillohet për herë të parë trajnimi i kandidateve në Modulin Auditim dhe Dhënie Sigurie i Avancuar, Drejtimi i Performancës i Avancuar dhe atë të Etikës Profesionale.

Sipas kalendarit të miratuar nga Këshilli Drejtues, për kandidatët e **vitit të dytë** u realizua trajnimi sipas Moduleve më poshtë:

Moduli 1 Nisur në 18 Qershor 2020 28 orë Raportimi Financiar i Avancuar (AFR -pjesa 2)	Moduli 2 Nisur në 2 Nentor 2020 46 orë Taksimi Avancuar	Moduli 3 Nisur në 7 Dhjetor 2020 40 orë Legjislacioni i Biznesit i Avancuar
--	---	---

Sipas kalendarit të miratuar nga Këshilli Drejtues, për kandidatët e **vitit të tretë** u realizua trajnimi sipas Moduleve më poshtë:

Nisur në 14 Shtator 2020 32 orë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit	Ne 28 Dhjetor 2020 Mbrojtja e Punimit Profesional
---	--

Frekuentimi i leksioneve të moduleve profesionale është i detyrueshëm në masën 75%, ndërsa frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%. Nga platforma janë gjeneruar raporte të ndryshme përfshirë dhe pjesëmarrjen në leksione dhe seminare.

Për sa i përket zhvillimit të trajnimit online me Zoom, lektorët dhe kandidatët kanë dhënë përgjithësisht feedback pozitiv. Lektorët e kanë zhvilluar trajnimin pothuajse si në kushte kualifikimi fizik, sigurisht duke i mbajtur të aktivizuar kandidatët me pyetje dhe përgjigje.

Megjithatë është konkluduar se zhvillimi i trajnimit me praninë fizike, ka efektivitet më të lartë në ndjekjen e trajnimit dhe përvetësimin e njohurive të marra.

Aplikacioni Google Classroom është përdorur me efektivitet për zhvillimin e seminarit. Në këtë aplikacion janë shkarkuar prezantimet e lektorëve, si dhe ushtrimet e kryera gjatë orëve të trajnimit.



Duhet të theksojmë se aplikacioni Google Classroom i ka mbajtur të aktivizuar kandidatët për sa i përket zhvillimit të orëve të seminarit. Ushtrimet e zgjidhura nga kandidatët janë rishikuar nga Sektori i Edukimit, për të cilat kandidatët kanë marrë vlerësimin individual për zgjidhjen e ushtrimeve. Në përfundim të orëve të trajnimit, kandidatëve ju janë dërguar nëpërmjet këtij aplikacioni edhe ushtrime të tjera për të përvetësuar më mire njohuritë e marra gjatë leksionit, duke i lënë disa ditë kohë (2-3) për zgjidhjen e tyre.

Për trajnimet e modurit “Taksimi i Avancuar” dhe “Legjislacioni i Biznesit i Avancuar” është përdorur aplikacioni ZOOM Webinar. Me anë të kësaj platforme u arrit të sigurohej edhe komunikimi me lektorin përkatës, pasi kandidatët mund të bënin pyetje nëpërmjet opsionit Q&A ose mund të ngrinin dorën nëpërmjet opsionit “Raise Hand”.

Gjatë vitit 2020 KEKV ka shqyrtuar dhe miratuar vendime lidhur me kandidatët që kryejnë praktikën profesionale, të grupuara si më poshtë:

- Vlerësimi i aplikimeve të personave që kanë shprehur interes për t’u pranuar si kandidatë në praktikën profesionale dhe miratimi i marrëveshjeve të nënshkruara me Auditues Ligjorë.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të kandidatëve si, ndërprerje të marrëveshjes së praktikës profesionale, kryerjen e orëve shtesë të praktikës profesionale, ndryshimin e drejtuesit të praktikës, etj.
- Vlerësimi i kryerjes nga kandidatët, të detyrimeve të parashikuara nga Ligji 10091 (i ndryshuar) dhe rregullorja e edukimit (trajnime, testime/ritestime dhe mbrojtja e punimit profesional për kandidatë në vitin e fundit të praktikës profesionale 2020.
- Vlerësimi i aplikimeve për përjashtime nga praktika profesionale për individë me 15 vite eksperiencë në fushën e kontabilitetit, auditimit, financës dhe legjislacionit dhe për përjashtime nga dhënia e disa provimeve për audituesit e huaj si mbajtës të titullit ACCA.
- Mbi “Relacionin për Vazhdimin e Moduleve Profesionale sipas Kurrikulës së profesionit të Audituesve Ligjorë” përgatitur nga Njësia e Edukimit, dhe propozimi për KD mbi disa ndryshime në programin e moduleve profesionale;

Sigurimi dhe Kontrolli i Cilësisë



Për të realizuar procesin e kontrollin e cilësisë, Këshilli Drejtues ka krijuar Komitetin e Kontrollit të Cilësisë, përbërja e të cilit është si më poshtë:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Arqile Mishtaku | Kryetar |
| 2. Vera Lala | Anëtar |
| 3. Erjon Pjeternikaj | Anëtar |
| 4. Brunilda Stefa | Anëtar |

Në ligjin e auditimit 10091 datë 05.03.2009 të ndryshuar me ligjin 47/2016 përcaktohet se, sistemi i dhënies së sigurisë për cilësinë përfshin dy hallka:

- a) kontrollin e cilësisë, që organizohet brenda shoqërisë së auditimit;
- b) kontrollin e cilësisë, që organizohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Kontrolli i cilësisë brenda firmës/kabinetit të auditimit duhet të garantohet përmes vendosjes së rregullave të brendshme të rishikimit për qëllime të kontrollit të cilësisë së angazhimeve, të cilat bazohen në SNKC1 dhe në udhëzimet përkatëse të përpunuara nga IEKA.

Procedura e kontrollit të cilësisë përcakton se kontrolli i cilësisë kryhet në bazë të një analize risku:

- të paktën një herë në çdo tre vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitë ekonomike me interes publik;
- një herë në çdo gjashtë vjet, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit që auditojnë njësitë e tjera ekonomike;
- një herë në dy vjet, derisa arrihet eksperiencia e kërkuar për audituesit ligjorë, me jo më shumë se pesë vjet përvojë pune në profesion.

Një nga pikat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Bordin e Mbikëqyrjes Publike që u nënshkrua në 11 shkurt 2021, është edhe delegimi i kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike që nuk janë me interes publik (JoEIP). Në këtë kuadër IEKA ka përmbushur detyrimin e saj sipas marrëveshjes, duke bërë rishikimin e Draft Rregullores nr. 7 të Kontrollit të Cilësisë datë 02.10.2018 “Për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor”, e ndryshuar, dërguar për mendim nga BMP.

Kontrolli i cilësisë për njësitë ekonomike jo me interes publik (JoEIP) përfshin kontrollin e dosjeve të auditimit, duke bërë një vlerësim të pajtueshmërisë me standardet e auditimit, me kërkesat e etikës

dhe të pavarësisë, një vlerësim të cilësisë dhe sasisë së burimeve të shpenzuara, të tarifave të auditimit të ngarkuara dhe një vlerësim të sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë të shoqërisë audituese (kabinetit në rastin e personit fizik).

Në këtë aspekt IEKA ka marrë masat, duke argumentuar se plotëson kërkesat e kriterëve të ligjit dhe për realizimin e këtij procesi:

- ✓ ka reformuar Komitetin e Cilësisë,
- ✓ ka një paketë të plotë të rregullave të kontrollit të cilësisë të cilat janë hartuar bazuar në eksperiencën e deritanishme dhe me ndihmën e konsulentit të projektit të BB,
- ✓ ka kërkuar që të punesojë dy Inspektorë të Cilësisë që plotësojnë kriteret e Ligjit 10091 datë 05.03.2009 (të ndryshuar).

Krahas reformimit të paketës së rregullave për kontrollin e cilësisë për JoEIP, IEKA po përgatit edhe:

- Një paketë të rregullave për kontrollin e cilësisë së shërbimeve të tjera.
- Organizimin e punës nga komiteti i kontrollit të cilësisë për verifikimin e zbatueshmërisë së standardeve profesionale dhe kërkesave ligjore nga Audituesit Ligjorë.

Materiali me rregulla për kontrollin e cilësisë së shërbimeve të kryera është marrë nga organizata profesionale FCM dhe është përkthyer nga IEKA.

Komiteti i Standardeve Profesionale

Anëtarët e Komitetit të Standardeve Profesionale, bazuar në nenin 21, të statutit të IEKAs, u miratuan me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 36 datë 17.10.2019.


Përbërja e Komitetit të Standardeve Profesionale:

- | | |
|-----------------|---------|
| 1. Berti PASHKO | Kryetar |
| 2. Artan XHIANI | Anëtar |
| 3. Hysen ÇELA | Anëtar |

Fokusi kryesor i këtij komiteti është trajtimi i çështjeve dhe kërkesave për interpretim lidhur me zbatueshmërinë e standardeve profesionale dhe të kodit të etikës.



Investigimi dhe Disiplina



Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës për vitin 2020, ka kryer disa procese investigimi nisur nga kërkesa - ankesa të ndryshme të ardhura në Institut ndaj anëtarëve të tij. Në përputhje dhe me objektivin e tij kryesor, ky komitet investigon sjelljet e anëtarëve të IEKA-s që bien në kundërshtim me:

- dispozitat e ligjit “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar” (i ndryshuar);
- aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
- aktet statutore të organizatës; dhe me
- standardet profesionale dhe kodin e etikës.

Përbërja e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës, për vitin 2020 rezulton si më poshtë:

1. Shkëlzen Margjeka Kryetar
2. Elton Tirana Anëtar
3. Majlinda Maqellari Anëtar

Ankesat drejtuar Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës gjatë këtij viti kanë të bëjnë kryesisht me çështjet si më poshtë:

- Evidentimi i disa shoqërive që mund të kenë kryer aktivitetin e auditimit ligjor ose përdorimin e titujve profesionale pa u regjistruar në Regjistrin Publik të IEKAs;
- Moszbatimi i kërkesave të SNSL 4400 “Angazhimi për kryerjen e procedurave

të rëna dakord” gjatë ushtrimit të profesionit nga një AL.


- Investigimi për ankesën e ardhur ndaj një AL për pajtueshmërinë e ushtrimit të profesionit;
- moszbatimi i kërkesave të Kodit të Etikës dhe procedurave të auditimit gjatë ushtrimit të profesionit të AL.

Në përfundim të procedurave të investigimit të realizuara nga anëtarët e tij, KID ka hartuar relacionet dhe ka marrë vendimet përkatëse të cilat i janë përcjellë për vendimmarrje përfundimtare Këshillit Drejtues të IEKAs.

Me gjithë përpjekjet e shumë anëtarëve për të respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi, të rregulloreve, të statutit, si dhe kodit të etikës të IEKAs, përsëri në praktikë vazhdojnë të vërehen raste kur këto kërkesa nuk zbatohen plotësisht. Mangësi vërehen në procedurat e marrjes përsipër të angazhimeve/misioneve, në zbatimin e tarifave të ulëta, jo-konkurruese dhe të pamjaftueshme për një auditim cilësor sipas SNA-ve, deklarime të pasakta në IEKA të angazhimeve të kryera dhe në veçanti mosdeklarimi i angazhimeve të ndryshme nga auditimi, siç janë raportet e ekspertëve për prokurorinë, gjykatën, raporte dhe shërbime të tjera, të cilat potencialisht mund të dëmtojnë profesionin e Audituesit Ligjor, nëse nuk respektojnë të njëjtën kërkesë etike sikurse edhe shërbimet e tjera.



Për vitin 2020, është vijuar puna për përkthimin në gjuhën shqipe dhe përditësimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB).



Gjatë muajit Maj ka përfunduar përkthimi i Volumit III i Manualit të IAASB, i cili i është shpërndarë anëtarëve të IEKAs nëpërmjet adresës së email si dhe është publikuar në faqen e web. Volumi III është shtesë e Deklaratave të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit e Sigurisë, të Standardeve mbi Kontrollin e Cilësisë, Auditimin, Rishikimin, Sigurive të tjera dhe Shërbimeve të Lidhura, si dhe Direktivën jo Detyruese të Praktikave Ndërkombëtare të Auditimit.

Ky volum përfshin dy nga temat që janë në fokus të IAASB:

1. Kuadri i IAASB për Cilësinë e Auditimit: Elementët kryesore që krijojnë një mjedis për cilësinë e auditimit; dhe
2. Kuadri Ndërkombëtar për Angazhimet e Sigurisë.

Kodi Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël, botim i vitit 2018, i përkthyer në gjuhën shqipe është publikuar në faqen e web si dhe është shpërndarë për anëtarët e IEKAs në adresat e tyre elektronike.




Kodi i ri është rishkruajtur tërësisht në një format të ri dhe ka një përmbajtje të përmirësuar, e cila bën më të lehtë referencimin në shumë çështje relevante dhe në përdorimin dhe zbatimin e tij të përshtatshëm nga profesionistët e auditimit dhe të tjerë të interesuar.

IEKA ka përkthyer dhe ka publikuar në faqen e web-it gjashtë seritë e para të publikimeve “Njohja me Kodin e IESBA-së” nga IFAC, të cilat kanë për qëllim të lehtësojnë implementimin e Kodit të Etikës si dhe të informojnë profesionistët kontabël mbi temat më të rëndësishme të Kodit. “Njohja me Kodin e IESBA-së” përbëhet nga dymbëdhjetë publikime mujore, të cilat fokusohen në një vështrim të hollësishëm të Kodit të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të

Pavarësisë). Këto publikime nxjerrin në pah në mënyrë praktike aspekte të ndryshme të Kodit të Etikës që kanë të bëjnë me situata reale, duke vendosur një fokus të veçantë në rishikimet më të fundit të Kodit.

Pjesët e “ Njohja me Kodin e IESBA-së” të publikuara në faqen e web-it të IEKAs janë:

- Pjesa 1: Pesë Parimet Themelore
- Pjesa 2: Kuadri Konceptual – Hapi 1, Identifikimi i Kërcënimeve
- Pjesa 3: Kuadri Konceptual – Hapi 2, Vlerësimi i Kërcënimeve



Për shprehje...
Si përdoren Parimet Themelore të Kodit të Etikës?
 Parimet Themelore të Kodit të Etikës janë ato që udhëzojnë profesionistët në marrëdhëniet me klientin, me kolegët dhe me publikun. Ata janë themelimi i të gjithë veprimeve të tyre dhe janë të nevojshme për të siguruar që të gjithë veprimet të jenë të drejta dhe të ndershme.

Çfarë është Kuadri Konceptual?
 Kuadri Konceptual është një proces i përbërë nga tre hapa kryesorë: 1. Identifikimi i kërcënimeve, 2. Vlerësimi i kërcënimeve dhe 3. Përkthimi i rezultateve në veprim. Ky proces është i nevojshëm për të siguruar që profesionistët të jenë të ndershëm dhe të pavarur në të gjithë veprimet e tyre.

Në praktikë...
 Në praktikë, kuadri konceptual është i nevojshëm për të siguruar që profesionistët të jenë të ndershëm dhe të pavarur në të gjithë veprimet e tyre. Ky proces është i nevojshëm për të siguruar që profesionistët të jenë të ndershëm dhe të pavarur në të gjithë veprimet e tyre.



Si përdoren Parimet Themelore të Kodit të Etikës?
 Parimet Themelore të Kodit të Etikës janë ato që udhëzojnë profesionistët në marrëdhëniet me klientin, me kolegët dhe me publikun. Ata janë themelimi i të gjithë veprimeve të tyre dhe janë të nevojshme për të siguruar që të gjithë veprimet të jenë të drejta dhe të ndershme.

Çfarë është Kuadri Konceptual?
 Kuadri Konceptual është një proces i përbërë nga tre hapa kryesorë: 1. Identifikimi i kërcënimeve, 2. Vlerësimi i kërcënimeve dhe 3. Përkthimi i rezultateve në veprim. Ky proces është i nevojshëm për të siguruar që profesionistët të jenë të ndershëm dhe të pavarur në të gjithë veprimet e tyre.

Në praktikë...
 Në praktikë, kuadri konceptual është i nevojshëm për të siguruar që profesionistët të jenë të ndershëm dhe të pavarur në të gjithë veprimet e tyre. Ky proces është i nevojshëm për të siguruar që profesionistët të jenë të ndershëm dhe të pavarur në të gjithë veprimet e tyre.

- Pjesa4:KuadriKonceptual – Hapi 3, Adresimi i Kërcënimeve
- Pjesa 5: Pavarësia
- Pjesa 6: Konfliktet e Interesit

Gjithashtu, është vijuar puna për përkthimin në gjuhën shqipe të Volumit II të Manualit të IAASB. Për vitin 2020, janë përkthyer dhe publikuar materiale të tjera ndihmëse lidhur me standardet profesionale duke u fokusuar në ndryshimet më të fundit të bëra nga IFAC, si dhe zbatimin e kërkesave të SNA-ve në një mjedis të karakterizuar nga pasiguri dhe sfida të shkaktuara nga COVID-19. Ndër të tjera veçojmë përkthimin e materialeve si më poshtë:

- *Ngjarjet e Mëvonshme në Mjedisin Aktual - Konsideratat e Auditimit për Ndikimin e COVID – 19;*
- *Ndikimi i COVID - 19 në auditim - Udhëzime për Audituesit (Guida e CA Pakistan);*
- *Nxjerrja në Pah e Aspekteve që Kërkojnë Vëmendje në një Mjedis Auditimi në Zhvillim si Pasojë e Impaktit të COVID-19;*
- *Zbatimi i Kërkesave të disa SNA-ve gjatë Auditimit Ligjor të Pasqyrave Financiare 2019 në Kushtet e Vlerësimit të Rrezikut të Shkaktuar nga Covid 19.*

Veprimtari me Organizmat Kombëtare

Viti 2020 njohu një rritje të mëtijshme të komunikimit të IEKAs me institucionet e pavarura dhe organet e tjera të administratës publike. Ky bashkëpunim i ka shërbyer rritjes dhe fuqizimit të rolit të profesionit, përmirësimit të cilësisë së punës dhe veçanërisht mbrojtjes së anëtarëve dhe të interesit publik. Zhvillimet ekonomike shoqërore të vendit e bëjnë gjithnjë e më të domosdoshme bashkëpunimin, në rradhë të parë midis anëtarëve apo segmenteve të ndryshme të profesionit dhe padyshim edhe me rregullatorët dhe aktorët e tjerë të pavarur e publikë. Thellimi i bashkëpunimit me organizatat e kontabilitetit në vend (IKM, SHKFSH, SHKM, etj.), Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Integritit, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Bordin e Mbikëqyrjes Publike, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Qendrën Kombëtare të Biznesit, me Universitetet (FEUT, UBT, etj.), me Dhomat e avokatisë dhe të tregtisë, si edhe me shumë organe të tjera të administratës publike, ka njohur një shkallë mjaft cilësore gjatë gjithë vitit të kaluar.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, ka ushtruar funksionin e tij të mbikëqyrjes së profesionit të AL dhe shoqërive audituese. IEKA ka qenë në komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me BMP. Gjithashtu BMP-ja ka ushtruar detyrën e tij mbikëqyrëse mbi veprimtarinë e anëtarëve të Institutit nëpërmjet kontrollit të cilësisë.

IEKA ka qenë aktiv në veprimtaritë profesionale të organizuara në vend.

DPPPP

Në kuadër të bashkëpunimit institucional, me qëllim zbatimin sa më të mirë nga audituesit ligjorë të ligjit “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave”, “Për masat kundër financimit të terrorizmit” dhe udhëzimeve përkatëse në zyrat e DPPPP-s në datë 15.09.2020 u zhvillua një takim i përbashkët midis organeve drejtuese të IEKA dhe DPPPP.

Çështjet të cilat u diskutuan në këtë takim ishin:

- I. Qartësimi i kërkesave ligjore - rregullatore për detyrimin për raportim nga Audituesit Ligjorë;
- II. Standardizimi i kërkesave të Audituesve Ligjorë për raportim në DPPPP;
Bashkëpunimi për krijimin e një dokumenti me kërkesat ligjore për AL.
- III. Raportimi Online i Audituesit ligjor pranë DPPPP/AFIU;

1. Si bëhet raportimi on line
 2. Kërkesat që duhet të plotësojë AL për tu regjistruar për raportim.
 3. Si mund të regjistrohet AL për trajnime në DPPP
- IV. Diskutim dhe qartësim i kërkesave të Aneksit të PPP për tu plotësuar nga AL në Gusht/Shtator 2020
1. A duhet të plotësohet nga të gjithë AL dhe për të gjitha shërbimet ndërkohë që në ligj përcaktohet se kontrolli nga DPPP bëhet gjatë inspektimit. (Nëse do dorëzohet afati të jetë data 31 Janar i cdo viti).
 2. Ka pyetje të cilat nuk mund të plotësohen nga Audituesi Ligjor.

DPT

Duke parë nevojën për bashkëpunim ndërinstitutional, shkëmbim informacioni dhe mirëkuptimi dypalësh, në mënyrë që të lehtësohet kryerja e funksioneve përkatëse, përfaqësues të IEKAs dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve zhvilluan një takim në datë 11 Shtator 2020 në ambientet e DPT.

Në përfundim të takimit u ra dakort të nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve me objekt bashkëpunimin ndërinstitutional në fushën e shkëmbimit të ekspertizave përkatëse, të informacionit, përgatitjes dhe zbatimit të legjislacionit tatimor e raportimit financiar, të organizmit të formimit profesional e të aktiviteteve të tjera të lidhura me fushën e tatimeve dhe të raportimit financiar.

QKB

Këshilli Drejtues në datë 27 Janar 2020 zhvilloi një takim me drejtues të Qendrës Kombëtare të Biznesit, më qëllim diskutimin mbi disa problematika të prezantuara nga Audituesit Ligjor pranë IEKA-s.

Në këtë takim drejtuesit e IEKA-s prezantuan problematikat e hasura në praktikë nga Audituesit Ligjor në momentet e regjistrimit në QKB të detyrimeve të përcaktuara në kuadrin ligjor - rregullator të ligjit të QKB, ligjit të auditimit, etj, në lidhje me:

- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, i cili është një shërbim i dhënies së sigurisë që duhet të kryhet nga audituesit ligjor bazuar në nenin 33, pika 4.1 e ligjit të auditimit 10091.
- Dorëzimin e pasqyrave financiare të subjekteve në QKB.
- Dorëzimin e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të shoqërive të audituara.
- Objektin e veprimtarisë së audituesve ligjor që regjistrohen në QKB.
- Pajtueshmërinë e ushtrimit të profesionit të audituesit ligjor i regjistruar si Person Fizik ose në Shoqëri Auditimi.

Njohjen e audituesve ligjor me ndryshimet e shërbimeve online të QKB nga Janar 2020 dhe projektet në vijimësi të QKB.

Veprimtaritë me Organizmat Ndërkombëtare



Gjatë vitit 2020, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar vijoi traditën e tij me konsolidimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me organizmat profesionale ndërkombëtare ku IEKA është anëtare aktive me të drejta të plota, siç janë:

FCM (*Federata e Ekspertëve Kontabël të Mesdheut*)

FCM është një shoqatë e krijuar në fund të vitit 1999 me iniciativën e drejtuesve të organizatave profesionale të vendeve të Mesdheut. Ajo mbledh së bashku organizatat profesionale të cilat veprojnë në vendet e Mesdheut dhe promovon bashkëpunimin midis organizatave profesionale në rajon, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, për të ndarë njohuritë dhe për të ofruar ndihmë teknike për anëtarët e saj dhe për t'i ndihmuar ata të arrijnë dhe mbajnë standarde të larta profesionale dhe të dhënies së sigurisë. IEKA është anëtare e FCM nga viti 2006.

Mbledhja e Këshillit të FCM u mbajt në datë 30 janar 2020, në kryeqytetin e Italisë, Romë, në të cilën IEKA ishte pjesëmarrëse. Mbledhja u fokusua në diskutimet mbi strategjinë dhe planet e aktiviteteve të ardhshme të FCM, duke u ndalur në Procesin e Kontrollit të Cilësisë për shërbimet e tjera joaudituese, digjitalizimin dhe auditimin e entiteteve të vogla dhe të mesme. Ndër të tjerë në këtë mbledhje të Këshillit të FCM morën pjesë përfaqësues të CSOEC & CNCC Francë, ACCA, SCAAK etj.

Mbledhja Vjetore e FCM u organizua online në datë 2 Korrik 2020, ku ndër të tjera u diskutua dhe u votua mbi Pasqyrat Financiare, Raportin e Audituesit dhe Raportin Vjetor për vitin 2018 dhe 2019. Në këtë mbledhje u diskutua edhe në lidhje me kuotën fikse për vitin 2021, ku u vendos që për arsyen e uljes së shpenzimeve dhe kufizimit të aktiviteteve të FCM si pasojë e COVID-19, kuota e anëtarësisë për vitin 2021 të jetë në vlerën zero. IEKA u përfaqësua në këtë mbledhje nga Kryetari i Këshillit Drejtues.

EFAA (*Federata Europiane e Kontabilistëve dhe Audituesve për SME-të*)

EFAA është një organizatë e krijuar në 1994 e cila mbledh së bashku të gjitha organizatat ndërkombëtare të kontabilistëve dhe audituesve anëtarët e së cilave sigurojnë shërbime profesionale kryesisht për Entitetet e Vogla dhe të Mesme në Europë. EFAA përbëhet nga 17 anëtarë që përfaqësojnë rreth 320,000 kontabilistë dhe auditues në të gjithë Europën. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar është anëtare me të drejta të plota në EFAA që nga viti 2016.

Konferenca Ndërkombëtare e EFAA u mbajt nëpërmjet videokonferencës në datë 26 qershor 2020, e cila u ndoq dhe nga përfaqësues të IEKAs. Në këtë mbledhje ndër të tjera u miratuan Pasqyrat Financiare të EFAA, plani i aktiviteteve për periudhën Korrik –

Dhjetor 2020, Buxheti për vitin 2021 dhe u përzgjedhën katër anëtarë të Këshillit Drejtues të EFAA.

Për vitin 2020 EFAA ka realizuar një seri webinaresh, ku mund të përmendim: në datë 9 Korrik EFAA zhvilloi webinarin me titull “E ardhmja e raportimit të SME-ve - Vështirësitë e hasura si pasojë e COVID-19”. Në këtë webinar u ndanë këshilla dhe udhëzime në lidhje me kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar që do të duhet të merren parasysh në adresimin e efekteve financiare të COVID-19 gjatë përgatitjes së pasqyrat financiare të SME-ve.

Banka Botërore

Përfaqësues të IEKAs morën pjesë në workshop-in e organizuar nga Banka Botërore mbi Raportin e ROSC (Report on the Observance of Standards and Codes) në datë 13 shkurt 2020. Në këtë workshop morën pjesë gjithashtu përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit.

CAG (Grupit Këshillues Konsultativ i IESBA dhe IAASB)

Mbledhjet e CAG IESBA dhe IAASB u zhvilluan online për vitin 2020. Përfaqësues të IEKAs morën pjesë në mbledhjet e Grupit Këshillues Konsultativ (CAG) të IESBA dhe IAASB. CAG është pjesë e rëndësishme e procesit të hartimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, të Kontrollit të Cilësisë, Etikës dhe shërbimeve të tjera profesionale. CAG ka në përbërje të tij përfaqësues të BB, Komisionit Europian, IASB, NASBA, IOSAI, etj, të cilët janë të interesuar në zhvillimin dhe mbajtjen e cilësisë së lartë të standardeve ndërkombëtare profesionale dhe etike të hartuara për ti shërbyer interesit publik.

ACCA

ACCA (Association of Chartered Certified Accountants) dhe IEKA në korrik të 2020 nënshkruan një marrëveshje dypalëshe, me anë të cilës anëtarëve dhe kandidatëve të IEKAs iu dha mundësia për të përfituar kushte të mira regjistrimi pranë ACCA (Association of Chartered Certified Accountants). ACCA është shoqata më e madhe ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit me përafërsisht 219,000 anëtarë dhe 527,000 studentë në 179 vende.

Në datë 15 Shtator 2020, EFAA organizoi webinarin me titull “E ardhmja e SME-ve: Likuiditeti dhe Vijimësia e Biznesit”. Disa nga çështjet që u diskutuan në këtë webinar ishin problemet e likuiditetit për SME-të gjatë pandemisë, masat e marra në nivel kombëtar, veprimet e ndërmarra nga BE për forcimin e likuiditetit, si dhe u prezantua “Cheklist për Vijimësinë e Biznesit të Vogël”, një tools i ndërtuar nga IFAC që u vjen në ndihmë bizneseve të vogla të prekura nga COVID-19. Pjesëmarrës në këto webinare ka qenë edhe Stafi Ekzekutiv i IEKAs.

Në vijim të kësaj marrëveshje, të gjithë anëtarët e IEKAs përfituan tarifa të arsyeshme në rast regjistrimi për titullin e ACCA.

IFAC (*Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve*)

Që nga viti 2000, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar është anëtarësuar në IFAC (Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve). Në vitin 2006 IEKA u bë anëtare me të drejta të plota.

IFAC është organizata që përfaqëson profesionin në rang ndërkombëtar, e dedikuar për t'i shërbyer interesit publik nëpërmjet forcimit të profesionit dhe duke kontribuar në zhvillimin e ekonomive të fuqishme ndërkombëtare. IFAC përbëhet nga 175 anëtarë dhe bashkëpunëtorë në më shumë se 130 shtete që përfaqësojnë mbi 3 milionë kontabilistë në praktikën publike, edukim, shërbimin qeveritar, industrinë dhe tregtinë.

Më datën 9 Prill 2020 u organizua në platformën Zoom, seksioni virtual i diskutimit mbi udhëheqjen e organizatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit organizuar nga IFAC.

Qëllimi i këtij diskutimi ishte shkëmbimi i ideve dhe eksperiencave rreth ndikimit të COVID - 19 në Organizatat Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit, veçanërisht në:

- Aktivitetet e organizatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit;
- Detyrimet e anëtarësisë;
- Strategjitë që duhen ndjekur në situatën aktuale.

Mbledhja vjetore e IFAC u mbajt nëpërmjet videokonferencës më datat 11-12 Nëntor, ku morrën pjesë dhe përfaqësues të IEKAs. Në këtë mbledhje ndër të tjera u diskutua dhe u votua mbi raportet e veprimtarisë së IFAC për vitin 2020, si dhe mbi plan strategjinë e IFAC për vitet e ardhshme.

Samiti Global i IFAC me temë “Kontabilistët e së Ardhmes: Trendet Globale, Transformimi i të Mësuarit dhe Zhvillimit” u organizua në mënyrë virtuale në datat 16 deri 19 Nëntor 2020, në të cilën morën pjesë dhe përfaqësues të IEKAs. Temat ku u përqëndrua samiti ishin teknologjia, mjedisi, shoqëria si dhe nevojat e profesionistëve kontabël lidhur me zhvillimin profesional. Gjithashtu u diskutua mbi ndryshimet e nevojshme në mbështetje të profesionit gjatë dhe pas pandemisë.

Gjatë vitit 2020, IFAC ka organizuar seri webinaresh me fokus cilësinë e praktikave të auditimit gjatë pandemisë, planifikimi i procesit të auditimit, gjetja e metodave të reja të punës, identifikimi dhe kontrolli i riskut, kryerja e auditimit dhe nënshkrimi i raportit të auditimit në kushtet e pandemisë. Pjesëmarrës në këto webinare ka qenë dhe Stafi Ekzekutiv i IEKAs.

SHKÇAK

Në kuadër të angazhimit të përbashkët, për të konkretizuar dhe çuar më tej marrëveshjen e bashkëpunimit midis ShKÇAK dhe IEKA më datën 24 Janar 2020, në zyrat e IEKA-s në Tiranë u zhvillua një takim i përbashkët midis organeve drejtuese të dy organizmave profesionale të fushës së kontabilitetit, auditimit e shërbimeve të tjera të lidhura. Duke parë zhvillimet ndërkombëtare, veçanërisht ato në nivele të Bashkimit Europian, përfaqësuesit e të dyja organizatave vunë theksin në rradhë të parë në rritjen e kapaciteteve të tyre, që do të shërbejnë për të ruajtur dhe rritur më tej reputacionin profesional të anëtarëve.

Në këtë aspekt u ra dakord që të punohet për hartimin e një plani konkret, në mënyrë që të bashkuar të sensibilizojmë të gjithë aktorët, faktorët, por edhe publikun, me qëllim që të promovojmë profesionin tonë në të dyja anët e kufirit, të evidentojmë më mirë rolin e shërbimeve të anëtarëve tanë, në funksion të një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe të një shoqërie me standarde sociale të përparura.

Në përfundim të këtij takimi u ra dakort se IEKA dhe ShKÇAK, do të angazhohen për:

1. Të realizuar disa tema të përbashkëta të kualifikimit të vijueshëm profesional për vitin 2020 dhe në vazhdim, si dhe mundësinë e organizimit të Konferencave të përbashkëta;
2. Të bashkëpunuar për kurrikulën e profesionit në trajnimet kandidatëve dhe aspirantëve për të hyrë në profesion, duke vlerësuar mundësinë e përdorimit të teksteve të përbashkëta;
3. Të vijuar bashkëpunimin e mëtejshëm në fushën e përkthimeve dhe botimeve profesionale si të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, Kodit të Etikës, SNAve etj;
4. Të kontribuar me botime me natyrë profesionale e shkencore nga anëtarë të ShKÇAK në revistën profesionale “Kontabilitet, Financë dhe Auditim” të IEKA-s;
5. Të shkëmbyer eksperiencën në fushën e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor dhe të shërbimeve të tjera si p.sh të shërbimeve të kontabilitetit.
6. Të bashkëpunuar në fushën e praktikës profesionale të kandidatëve dhe aspirantëve për të hyrë në profesion, duke vlerësuar mundësinë e njohjes pjesore të praktikave të kryera në të dy vende.

Struktura Ekzekutive

Stafi Ekzekutiv i IEKAs funksionon në bazë të strukturës së miratuar nga Këshilli Drejtues dhe të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës Ekzekutive të IEKAs, të miratuar me vendimin nr. 33 datë 05.11.2014 të KD dhe të rishikuar me vendimin nr. 49 datë 04.12.2019 të KD. Në këtë rregullore është përcaktuar struktura organizative dhe përshkrimet e punës të stafit ekzekutiv. Modeli i strukturës së re është mbështetur në strukturën ekzistuese, por u riformatua për të mundësuar mbulimin më të mirë të funksioneve të IEKAs.


Struktura e personelit ekzekutiv e cila përbëhet nga:

Punonjësit me kohë të plotë:

- | | |
|--------------------|---|
| 1. Elvira Hoxha | Drejtor Ekzekutiv |
| 2. Elda Luga | Specialist Edukimi |
| 3. Valentina Sora | Specialist Edukimi dhe Finance Kontabiliteti |
| 4. Tedi Ziko | Specialist, Standardet profesionale |
| 5. Sara Shurdhi | Specialist, Standardet profesionale |
| 6. Eralda Kullolli | Sekretare |
| 7. Albana Pllaha | Detyra e mirëmbajtjes (pastrimit) të ambjenteve |

Në fund të vitit 2020 janë larguar nga puna me dëshirën e tyre punonjësit Elda Luga, Valentina Sora. Gjatë vitit 2021 janë larguar edhe punonjësit Eralda Kullolli dhe Sara Shurdhi dhe ka filluar punën në pozicionin e juristes zj. Eniela Agolli.

Struktura e stafit ekzekutiv të IEKAs sipas gjinisë:



Gjatë vitit 2020, stafi Ekzekutiv i IEKAs ka realizuar detyrat funksionale duke ndjekur Programin e Punës së KD për vitin 2020, si dhe detyrat e përcaktuara në kontratën individuale të punës. Për plotësimin e

strukturës organizative të ekzekutivit të miratuar, prioritet për vitin 2020 mbetet plotësimi i stafit me një punonjësi të ri, angazhimi me kontratë shërbimi i 2-3 audituesve ligjorë joushtrues të profesionit për ti angazhuar si Inspektorë të KC si dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit .

Informacioni i paraqitur për vitin 2020 jep një paraqitje të aktiviteteve të kryera nga IEKA bazuar në Ligjin 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të AL dhe të KM” (të ndryshuar), Statutin dhe rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Institutit.

Zhvillimi i burimeve njerëzore i shërben rritjes së kapacitetit profesional të punonjësve në përputhje me misionin dhe objektivat e IEKAs. Qëllimi kryesor mbetet zhvillimi i profesionalizmit të punonjësve të stafit ekzekutiv, motivimi i tyre për arritjen e objektivave si dhe plotësimi i burimeve njerëzore gjithnjë e më cilësore.



Realizimi i treguesve të buxhetit dhe veprimtaria financiare

Në përmbushje të detyrave të parashikuara në Ligjin 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) dhe në Statutin e IEKAs, paraqësim si më poshtë informacionin për realizimin e buxhetit të Institutit për vitin 2020.

Bazuar në nenin 25 të Statutit, veprimtaria financiare e Institutit dhe zbatimi i procedurave kontabël verifikohet nga Komiteti i Kontrollit të Brendshëm. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit të Brendshëm janë zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve (vendimi nr. 142 datë 30.09.2019) dhe kanë mandat 4-vjeçar. Gjithashtu bazuar në nenin 25.2 të Statutit, Pasqyrat Financiare të IEKAs auditohen nga audituesit ligjorë të cilët janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve (vendimi nr. 136 datë 28.06.2018) dhe nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 31, datë 02.09.2019.

Buxheti i vitit 2020, sipas përcaktimit në nenin 8.1 të Statutit është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve e datës 12 qershor 2019 (vendimi nr. 139).

Nga ana e KD i është kushtuar një kujdes i veçantë ndjekjes së aspekteve financiare jo vetëm në drejtim të ruajtjes së kufijve buxhetore por edhe në drejtim të gjetjes së mundësive të reja dhe përdorimit të burimeve me efikasitet maksimale, duke respektuar kërkesat e Ligjit, të Rregulloreve dhe të Statutit të IEKAs.

Në pjesën e dytë të raportit janë dhënë në mënyrë më të detajuar treguesit financiarë, ku është përfshirë dhe raporti i audituesve të pavarur. Këta tregues tregojnë kujdesin e Drejtimit dhe të KD për vlerësimin e çdo harxhimi financiar në funksion të domosdoshmërisë së tij dhe performancës aktuale e asaj të ardhme.

Realizimi i buxhetit të Institutit për vitin 2020 është bërë në përmbushje të detyrave të parashikuara në Ligjin 10091 datë 05.03.2009 (të ndryshuar) dhe në Statutin e IEKAs.

Burimet (të ardhurat) gjithsej për vitin 2020 nga 27.250.000 lekë të planifikuara janë realizuar 31.965.296 lekë ose në masën 117 %. Kontributi kryesor në grupin e të ardhurave i përket të ardhurave të paguara nga kuota fikse e anëtarësimit. Të ardhurat nga kuota fikse përbëjnë 50.25 % të të ardhurave vjetore të Institutit, nga 48.68 % që përbënin vitin e kaluar.

Burimet (të ardhurat) nga kuotat e regjistrimit të kandidatëve për vitin 2020 janë realizuar në vlerën 2.550.000 lekë ose 170 % të buxhetit të parashikuar. Kjo rritje vjen për arsye të rritjes së numrit të kandidatëve të regjistruar në praktikën profesionale si dhe të rritjes së tarifës së regjistrimit. Nisur nga ndryshimet të bëra në mënyrën e realizimit të trajnimeve gjatë praktikës profesionale (krijimi i shkollës postmaster), përdorimi i literaturave dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies, etj. Këshilli Drejtues gjatë vitit 2020 ka rishikuar edhe tarifat e trajnimeve e cila nga 50.000 lekë u rrit në 75.000 lekë, si pasojë e reformimit të kryer në mënyrën e realizimit të trajnimeve gjatë praktikës profesionale.

Shpenzimet nga 33.022.000 lekë të buxhetuara, janë realizuar 23,530,182 lek ose në masën 71%. Shpenzimet janë realizuar 29% më pak në krahasim me buxhetin e miratuar, ku për shkak të pandemisë një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve, nuk mund të realizoheshin. Mund të përmendim shpenzimet e asamblesë së përgjithëshme të anëtarëve e cila u realizua online, shpenzimet për udhëtime e djeta të cilat nuk u realizuan pothuajse fare, shpenzime për botime, shpenzime për paga pasi pritet delegimi i kontrollit të cilësisë për entitetet jo me interes publik etj. Në buxhetin e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme është planifikuar që Teprica e burimeve të vitit financiar të jetë (5.681.000) lekë dhe në fakt është realizuar në shumën 6,197,543 lekë.

Burimet dhe përdorimet e fondeve financiare të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar për vitin 2020 janë realizuar si më poshtë:

	Buxheti 2020	Realizimi 2020	në %
Nga aktiviteti			
Të ardhura	24,200,000	28,339,058	117 %
Shpenzime	27,522,000	20,448,864	75 %
Teprica nga aktiviteti	(3,322,000)	7,890,194	
Botimet (Revista dhe të tjera)			
Të ardhura nga botimet	150,000	3,400	2 %
Shpenzime për botimet	2,200,000	82,877	4 %
Teprica nga botimet	(2,050,000)	(79,477)	
Nga Kualifikimet			
Të ardhura	2,700,000	3,320,000	123 %
Shpenzime	3,300,000	2,996,446	91 %
Teprica nga kualifikimet	(600,000)	323,554	

Të ardhura nga depozitat	200,000	295,733	148 %
Teprica nga kursi i këmbimit		5,110	
Aktiviteti sipas vendimit Asamblesë			
Teprica përfshirë investimin	(5,681,000)	6,197,543	

Pasqyrat Financiare të Audituarra janë bashkëlidhur dhe janë pjesë e këtij raporti.